URDHËR
Nr.669, datë 22.5.2008

PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTAT E LIDHURA ME TË DREJTËN E AUTORIT TË ARTISTËVE INTERPRETUES DHE/OSE EKZEKUTUES TË VEPRAVE AUDIOVIZUALE, KOREOGRAFIKE, KINEMATOGRAFIKE, TEATRORE, DRAMATIKE E MUZIKORE TË REGJISTRUARA NË MBAJTËSE ZËRI/ZËRI-FIGURE

Duke marrë parasysh dokumentet e mëposhtme, bashkëlidhur:

1. kërkesën dhe dosjen me dokumentacionin e Agjencisë "AKDIE",

2. propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, nr.302, prot., datë 14.5.2008 për licencimin e kësaj Agjencie në fushën e menaxhimit të të drejtave të artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues,

3. vlerësimin e Drejtorisë së Hartimit dhe Përafrimit të Legjislacionit dhe Shërbimeve Juridike të MTKRS, mbi ligjshmërinë e kërkesës dhe dosjes,

konstatova se, në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", është kompetencë e Ministrit miratimi i dhënies së licencës së kësaj agjencie.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 124 pika 1 të "Kodit të Procedurave Administrative" dhe të neneve 108 pika 1, 109 pika 2 dhe 3 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të",

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave audiovizuale, koreografike, kinematografike, teatrore, dramatike e muzikore të regjistruara në mbajtëse zëri/zëri-figure.

2. Afati i licencës është tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Ylli Pango

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

LICENCË
Nr.3, datë 9.7.2008

Në mbështetje të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" dhe vendimi të Këshillit të Ministrave nr.232, datë 19.4.2006, vendimit nr.343, datë 6.6.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tarifave për shërbimet, që ofron Zyra Shqiptare për të drejtat e autorit", Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

VENDOSI:

Të licencoj "AKDIE"

Agjenci e Administrimit Kolektiv për të drejtat e artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues të veprave me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik.

Njohur si person juridik me vendim të Gjykatës së Tiranës, me nr.2224, datë 4.4.2008.

Selia e ushtrimit të veprimtarisë: Rruga "Kavajës", përballë Raiffeisen Bank, Tiranë.

Drejtues z.Arben Duro.

Licenca është e vlefshme për një periudhë 3 (trevjeçare).

Licenca duhet të ekspozohet në zyrat e Agjencisë.

MINISTRI I KULTURËS, TURIZMIT,
RINISË DHE SPORTEVE
Ylli Pango